

eppc kërkon një Drejtor IT për klientin e saj i cili është biznes i konsoliduar dhe me një pozicion të qëndrueshëm në tregun Shqiptar. Biznesi ushtron prej më shumë se 15 vitesh aktivitetin në fushën e tregtisë me shumicë të artikujve ushqimore duke përfaqësuar 104 marka të ndryshme për të cilat gëzon ekskluzivitetin e tregtimit në Shqipëri dhe në Ballkan.

Ky pozicion ka të bëjë me mbështetjen e njësisë të ndryshme të kompanisë për të verifikuar dhe siguruar që funksionet e sistemit kënaqin nevojat e biznesit. Gjithashtu ky pozicion ka të bëjë me vlerësimin e furnitorëve për programe dhe pajisje të lidhura me IT, zhvillimin e projekteve të informatizimit të aktiviteteve të ndryshme, hartimin dhe ndjekjen e buxheteve për nevojat e IT, etj.

KËRKESAT PËR KËTË POZICION JANË:

- Arsimi i lartë në Informacion dhe Teknologji, inxhinieri ose fusha të ngjashme.
- Diploma të niveleve master ose specializime të ndryshme përbëjnë avantazh.
- Zotërimi i gjuhës Angleze është domosdoshmëri
- Eksperiencë në punë të mëparshme në fushën e IT-së.
- Njohuri në funksionimin e biznesit
- Aftësi në menaxhim projekti.
- Aftësi në vendimmarrje si dhe në analizimin dhe zgjidhjen e problemeve.
- Aftësi komunikuese dhe bashkëpunuese

Të dhënat

Pozicioni:	Drejtor IT
Vendndodhja:	Tiranë
Orari:	40 ore pune në javë
Vartës direkt:	Po
Raporton tek:	Drejtori i Përgjithshëm
Udhëtime pune:	Rrallë.
Pagesa:	Pagë bazë + bonus në varësi të performancës
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës
Aplikimet mbyllen:	20.08.2011

Si të aplikoni

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur pozicionin për të cilin aplikoni tek:

info@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.